



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/39
Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të "Trepça Sh. A." emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Ardian Sylja, kryesues;
 - 1.2. Z. Naser Peci;
 - 1.3. Z. Feriz Fetahu;
 - 1.4. Z. Xhafer Nuli;
 - 1.5. Z. Shyqyri Sadiku;
 - 1.6. Z. Esat Peci.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe me Ligjin nr. 05/L-009, në pajtim me Ligjin nr. 05/L-120 për Trepçën, si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/39
Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/39

Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/39

Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për Menaxhimin e Projekteve në Fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/39
Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues Teknik me qëllim të propozimit të zhvillimit të Minierës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës.
2. Grupi Punues Teknik do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1. Korporata Energjetike e Kosovës - tre përfaqësues (një anëtar i Bordit të Drejtorëve, dy nga menaxhmenti i lartë);
 - 2.2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik - një përfaqësues;
 - 2.3. Ministria e Financave - një përfaqësues;
 - 2.4. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - një përfaqësues;
 - 2.5. Njësia Implementuese për Projektin "Kosova e Re" - një përfaqësues;
 - 2.6. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës - një përfaqësues;
 - 2.7. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - një përfaqësues;
 - 2.8. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Fakulteti i Gjeoshkencave - Xehtari - një përfaqësues;
 - 2.9. Instituti INKOS Sh.A. - një përfaqësues;
 - 2.10. Ekspertë të pavarur, me propozim të Qeverisë;
3. Grupi Punues Teknik udhëhiqet nga përfaqësuesi i Korporatës Energjetike të Kosovës, i cili përgatitë propozimin final për Qeverinë, jo më larg se data 10 prill 2018.
4. Mandati i Grupit Punues Teknik përfundon me dorëzimin e propozimit final në Qeveri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/39
Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për njohjen reciproke të Patentë Shoferëve.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Punëve të Brendshme obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/39
Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e "Marrëveshjes për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/39
Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut lidhur me Projektin për zhvillim të bashkëpunimit "KSV/020: Mbështetje për Reformën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë - Faza 2".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/39

Datë: 04.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 4. të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA-së), në Kuvendin e Republikës e Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Prof. Ass. Dr. Vjollca Krasniqi;
 - 1.2. Prof. Ass. Dr. Arta Jakupi;
 - 1.3. Dr. Sc. Spec. Rozafa Koliqi-Lila;
 - 1.4. Prof. Dr. Magdalena Ziolo;
 - 1.5. Prof. Dr. Gazmend Luboteni;
 - 1.6. Prof. Dr. Herbert K. Amato;
 - 1.7. Prof. Dr. Xhavit Rexha;
 - 1.8. Prof. Msc. Jeffery Butel;
 - 1.9. Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka;
2. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA-së), zgjidhet më mandat të caktuar për pesë vite.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e ratifikimit të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë